

Vendim nr. 166, datë 22.05.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryetare
Sonila Bejtja,	Anëtare
Sandër Beci,	Anëtar

në datën 22.05.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 15 (A) 2026 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: ARTA NAZIF, përfaqësuar nga avokatja Dhurata Haveri, me prokurë të posaçme.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 63, datë 10.10.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 7 (87-2024-48), datë 21.02.2024 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2025-1024, datë 24.06.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 30, 42, 131, 134 dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 27 e vijues dhe 71 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja, me detyrë “oficere” e Policisë Gjyqësore (*OPGJ*) në seksionin për Hetimin e Krimin Ekonomik e Financiar pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë (*DVP-ja, Tiranë*), ka ndjekur kallëzimin penal të shtetasës M.I. ndaj stomatologes (të bashkëpandehurës) E.S. për “mjekim të pakujdesshëm”, pasi kjo e fundit i ka shkaktuar kallëzueses dëmtime të sinusit gjatë trajtimit dentar në klinikën “L”. Në kuadër të verifikimeve për këtë kallëzim, në prezencë të administratores së klinikës (të bashkëpandehurës) D.M. (motra e stomatologes E.S.) është ushtruar kontroll në këtë klinike më 07.02.2023, rezultatet e të cilit, sipas procesverbalit të kontrollit, të përpiluar nga OPGJ-të A.V. dhe M.P., ku janë evidentuar, përveç të tjerave, edhe prezenca e produkteve kozmetike të padeklaruara, pa pullë fiskale, të dyshuara si kontrabandë. Në po të njëjtën datë ka dhënë deklaratimet përpara kërkueses edhe E.S. edhe D.M., të cilat kanë pohuar, ndër të tjera, se produktet kozmetike kanë qenë të rregullta dhe se disponohej faturë për to. Në vijim të hetimit, kërkuesja ka vendosur caktimin e një eksperti për kryerjen e ekspertimit mjeko-ligjor për kallëzuesen lidhur me dëmtimet e pësuar prej saj dhe, më 08.02.2023, ka referuar materialet procedurale në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për veprat penale të parashikuara nga nenet 96 “Neglizhenca në trajtimin mjekësor” dhe 172 “Kontrabanda me mallra për të cilat paguhet akcizë ose me pezullim të plotë apo të pjesshëm nga detyrimet doganore ose të akcizës” të Kodit Penal (*KP*).

2. Lidhur me këtë ngjarje, nga ana e Drejtorisë Rajonale të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore Tiranë janë referuar aktet në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*), në ngarkim të kërkueses dhe 2 të bashkëpandehurave E.S. dhe D.M.. Për këtë procedim Prokuroria e Posaçme ka kryer një sërë veprimesh hetimore, si pyetja e të pandehurave dhe personave që kishin dijeni rreth ngjarjes, këqyrja e kamerave të një subjekti dhe të DVP-së, Tiranë, këqyrja e aparateve celulare të të pandehurave dhe personave të tjerë që kishin dijeni rreth ngjarjes si dhe përgjimi telefonik. Në përfundim të hetimeve, Prokuroria e Posaçme e ka dërguar çështjen për gjykim, duke e akuzuar kërkuesen për veprën penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve, dhe i funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, të parashikuar nga neni 319/ç i KP-së dhe dy të bashkëpandehurat E.S. dhe D.M. për veprën penale “Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 319 e 25 të KP-së.

3. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*), me gjykim të shkurtuar, me vendimin nr. 63, datë 10.10.2023, ka vendosur deklarinimin fajtores të kërkueses për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni pasiv i

gjqtarëve, prokurorëve dhe i funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, të parashikuar nga neni 319/ç i KP-së dhe dënimin e saj me 3 vjet burgim. Për shkak të gjykimit të shkurtuar, kërkuesja është dënuar përfundimisht me 2 vjet burgim, konvertuar me kusht në shërbim prove për 4 vjet. Kërkueses me këtë dënim i është hequr edhe e drejta për të ushtruar funksione publike, për një periudhë kohore prej 5 (pesë) vjetësh. Me këtë vendim janë dënuar edhe dy të bashkëpandehurat, duke iu konvertuar vendimi me kusht dhe duke u vendosur në periudhë prove. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim kërkuesja.

4. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*), me vendimin nr. 7 (87-2024-48), datë 21.02.2024, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 63 datë 10.10.2023 të GJKKO-së së Shkallës së Parë. Mbi rekursin e kërkueses, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2025-1024, datë 24.06.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit pasi nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara nga neni 432 i Kodit të Procedurës Penale (*KPP*).

5. Në datën 13.02.2026 (sipas shërbimit postar), kërkuesja ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 27.02.2026.

II

Pretendimet e kërkueses

6. **Kërkuesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar *parimi i prezumimit të pafajësisë i lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor dhe me të drejtën e aksesit*, pasi gjykatat e zakonshme e kanë zhvilluar procesin me bindjen se kërkuesja e kishte kryer veprën penale për të cilën akuzohej, ndërkohë që ajo është dënuar pa prova dhe vetëm mbi bazën e dyshimeve dhe dëshmive të të dy të bashkëpandehurave. Gjykatat e kanë bazuar bindjen e tyre mbi fajësinë vetëm në pamjet e një zarfi, i cili nuk është sekuestruar dhe nuk është gjetur kurrë, duke e çuar dyshimin në favor të akuzës dhe jo të kërkueses. Për sa i takon zarfit që del në këqyrjen e kamerave të lokalit askush nuk e di se çfarë kishte aty, ndërkohë që kërkuesja pretendon se ishte disku me grafinë e kallëzueses. Në këtë mënyrë gjykatat e zakonshme ia kanë kaluar barrën e provës kërkueses. Gjithashtu, në vërtetimin e fajësisë gjykatat kanë vlerësuar se korrupsioni ka ardhur si pasojë e favorizimit të të bashkëpandehurave, ndërsa ky fakt nuk arrin të vërtetohet. Një tjetër prezumim i gabuar nga gjykatat e zakonshme është edhe fakti se ajo është takuar në kafene me të bashkëpandehurat dhe jo në zyrë. Nga këto rrethana, rezulton se gjykatat e zakonshme nuk kanë përcaktuar drejt faktet e çështjes, të cilat ishin të

rëndësishme për përcaktimin e përgjegjësisë ligjore, si dhe nuk kanë arsytuar për shkallën e rëndësisë që luan secili prej fakteve të analizuara në vërtetimin e veprës penale ose si ky fakt lidhet me kërkuesen. Gjykata e Lartë nga ana e saj ka mbajtur një qëndrim formalist duke mos i riparuar shkeljet e bëra nga gjykatat e faktit.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkueses

7. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

8. Për sa u takon kriterëve kumulative, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Mbledhja e Gjyqtarëve evidenton se gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kriterëve të legjitimitimit, në varësi të elementeve ose veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë për kërkuesin. Në këtë drejtim, mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, pa ndjekur një radhë të caktuar të analizës së kriterëve, me pasojë moskalimin e saj në seancë plenare, e bën të panevojshëm verifikimin e kriterëve të tjera. Në rastin kur verifikohet dhe arsytetohet mosplotësimi i vetëm një kriteri, kjo vjen si rezultat i zbatimit të karakterit kumulativ të tyre dhe nuk nënkupton se kriteret e tjera paraprake humbasin rëndësinë që kanë për rezultatin e çështjes, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit kriter që të vendoset moskalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare (*shih vendimin nr. 112, datë 30.04.2025 të Mbledhjes së Gjyqtarëve*).

9. Në lidhje me legjitimitimin *ratione temporis*, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës, ankimi kushtetues individual shqyrtohet nga Gjykata kur kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit. Në lidhje me llogaritjen e afatit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, Gjykata ka theksuar se në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të

cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Lidhur me llogaritjen e afatit të ankimit kushtetues individual, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka pohuar se duhet shpjeguar mënyra në të cilën individ mund të sigurojë provën e datës së njoftimit ose përse vetëm individ duhet të ketë barrën e provës në këtë drejtim. Sipas saj, i takon Gjykatës së Lartë të sigurojë që në dosjen e saj të çështjes të ketë prova për datën e dorëzimit të vendimit palëve (*shih Ibrahimimi dhe të tjerë k. Shqipërisë, datë 14.01.2025, § 13*).

10. Në çështjen konkrete, Kolegji evidenton se vendimi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesja, ai i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, mban datën 24.06.2025, kurse kërkesa është paraqitur në Gjykatë më 13.02.2026 (sipas shërbimit postar). Për qëllime të këtij shqyrtimi, Gjykatës së Lartë i është kërkuar informacion, e cila, në datën 31.03.2026, ka sqaruar se vendimi i kundërshtuar është publikuar në faqen e saj zyrtare në datën 01.08.2025. Nga ana e kërkueses, në ankimin kushtetues individual është pretenduar se ajo ka ardhur në dijeni të vendimmarrjes në datën 25.11.2025, kur i është drejtuar sekretarisë së Gjykatës së Lartë për informacion.

11. Në lidhje me këtë fakt nga ana e kërkueses, në ankimin kushtetues individual është pretenduar se ajo i është drejtuar sekretarisë së Gjykatës së Lartë në datën 25.11.2025 për t'u informuar zyrtarisht për çështjen e saj dhe se ankimi është paraqitur në Gjykatë brenda afatit ligjor 4-mujor. Kolegji vëren se për këtë pretendim, nga verifikimi i akteve të dosjes gjyqësore rezultoi se në datën 30.07.2025, nga ana e Gjykatës së Lartë, është njoftuar me *e-mail* mbrojtësi me prokurë i kërkueses, i cili ka nënshkruar edhe rekursin në emër të saj, duke iu komunikuar vendimi i asaj gjykate në adresën elektronike ardleka@yahoo.com. Kolegji gjithashtu evidenton edhe faktin se kërkuesja nuk ka qenë në izolim me burg, çka do të vështirësonte marrjen e dijeni nga ana e saj.

12. Ndodhur në këto kushte, Kolegji konstaton se Gjykata e Lartë është investuar nga kërkuesja nëpërmjet rekursit, duke kundërshtuar vendimin e GJKKO-së së Apelit që e kishte dënuar atë duke u përfaqësuar me avokat, rrethanë kjo që tregon se ajo kishte interesin dhe mundësitë për të ndjekur fatin e rekursit të saj, por në fakt nuk ka treguar dilijencën e duhur, ndërkohë kur nga dosja gjyqësore e Gjykatës së Lartë rezulton e provuar se është njoftuar mbrojtësi i saj me prokurë. Nga këto fakte, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual i kërkueses është dorëzuar në gjykatë rreth dy muaj e gjysmë tej afatit ligjor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i Ligjit Organik të Gjykatës.

13. Në kushtet kur ky kriter paraprak nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kritereve të tjera të pranueshmërisë bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

14. Nisur nga sa më sipër, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.